

ANTARESIMET E BASHKPUNIMIT ME SHOQATA E PROJEKTE TE KESHILLIT

BASHKIAK Mat

Këshilli Bashkiak Mat është I përbërë nga 21 anëtare mes të cilëve edhe gra keshilltare të nderuara.

Gratë këshilltare bëjnë pjesë në ALEANCEN E ZGJERUAR TE GRAVE KESHILLTARE Mat që është pjesë e Aleancën e Kombëtare të këshilltarëve .

Aleanca e grave këshilltare luan një rol kyc për të siguruar gjithpërfshirjen sociale.Gratë synojnë barazi gjinore kjo tashmë e ka shtuar edhe kërkesën e konkurrencës.

Gratë këshilltare e përceptojnë si përgjegjesi të tyre përfaqësimin e interesave të grave dhe vajzave në këshillin bashkiak, e këtë detyrë e kanë marë dhe po e mbajnë me rigoroziter anëtarët e këshillit Bashkiak Mat zonjat e sipërpërmendura , të cilave ju mbetet punë e detyra për të bërë jo vetëm gjatë mandatit por edhe në vazhdimsi.

Këshilli Bashkiak Mat është i anëtarësuar edhe në shoqatën e Qarqeve e cila është një organizatë jopolitike , jofitimprurëse. Kjo shoqatë është anëtare e këshillit konsultativ të Qeverisjes Qëndrore/ Vetëqeverisjen Vendore strukturë kjo që siguron konsultimin e diskutimin e gjërë të nismave ligjore të qeverisë qëndrore me organet e vetëqeverisjes vendore. Kjo shoqat është bashkim vullnetar I pavarur I të gjitha Këshillave të Qarqeve të Republikës së Shqipërisë si subjekte juridike publike dhe cdo të zgjedhurit në këto këshilla.

Këshilli Bashkiak Mat bashkëpunon me shume donatore ky kryesori eshte projekti Zviceran Bashki të Forta i cili ndjek strategjitë dhe politikat kombëtare zyrtare të zhvillimit duke punuar se bashku me administratën vendore dhe qeverisjen qëndrore. Ky projekt ka mbeshtetur 61 bashkitë e vendit, këshillin Bashkiak në përmisimin e shërbimeve dhe rritjen e orientimit të menaxhimit, hartimin e rregulloreve si dhe asistencë në zbatimin e tyre, duke I bërë ato me të zbatueshme e transparente, me një faqe webi sa me te pasur me informacione për qytetarët ashtu sic është edhe synimi I këtij projekti për Shqipërinë të përfitojnë në nivel vendor nga bashkitë e orientuara drejtë qytetarëve.

Këshilli Bashkiak është paisur me regjistra për : 1. kërkesa , ankesa , vërejtje,2. Regjistër për konsultimet me publikun 3. Regjistër për pedicionet të cilat qytetarët I gjejnë lehtësishtë në faqen e këshillit bashkiak pa qenë nevoja të shkojnë në zyrë për të verifikuar kërkesën e tyre .4. Regjistri elektronik I mbledhjeve të këshillit si dhe I project akteve.

Transparente janë edhe Vendimet e Këshillit Bashkiak të cilat gjënden ne faqen e vendimeve .

Këshilli Bashkiak është gjithmonë i hapur për bashkëpunime e asistence ne mbarvajtjen e punëve të tij.